



0100 1010 0101 11 10
00101 11001 00100 110
11 10100 00010111 10
1000 0001 1 10001
1010 010 000



0100 1010
00101 110
00 0
1000 0001

Instituti për Studime të Luftës Hibride

<http://octopusinstitute.org/>

Ngritja e së Djathtës Ekstreme në Evropë dhe Balkan: Sfondi Historik, ideologjia, Ndikimi Politik dhe Potenciali i Rritjes

Kush jemi ne

Fokusi parësor i Institutit për Studimin e Luftës Hibrade Octopus është studimi dhe analizimi i luftës hibrade, duke përfshirë taktikat, strategjitë, dhe implikimet e mundshme për sigurinë në rajon dhe më gjerë. Octopus synon të promovjë njohuri gjithpërfshirëse dhe debate për luftën hibrade dhe implikimet e tyre në peisazhin e sigurisë. Hulumtimet dhe analizat tona kontribuojnë në formësimin dhe zhvillimin e strategjive efektive dhe masave për garantimin e sigurisë ndaj rreziqeve në rritje. Hulumtimet tona thellohen në studimin e luftës hibrade, rreziqeve hibrade, investigimin e teknologjisë dhe eksplorimin e peisazheve dhe balancave të ndërlikuara, si dhe analizën e politikave dhe strategjive. Hulumtimet tona ofrojnë rekomandime dhe shërbejnë si orientim për adresimin dhe parandalimin e rreziqeve.

Autorët:

Agim Musliu

Taulant Elshani

Hyrje

Fenomeni i së djathtës ekstreme ka shënuar një rritje të vazhdueshme përgjatë gjithë Evropës viteve të fundit, duke rezultuar në një sërë trendesh dhe ngjarjesh shqetësuese. Ky hulumtim synon të analizoj faktorët që kanë çuar në ngritjen dhe ndikimin që mund të ketë në demokracinë dhe sigurinë evropiane.

Propaganda e ekstremit të së djathtës ekstreme historikisht ka qenë më shumë efektive në kohën e krizave dhe pasigurive ekonomike. Pandemia e fundit me COVID-19, problemet me linjat e furnizimit, ngritja e inflacionit, të cilat kanë çuar në situata të vështira miliona njerëz në Evropë, kanë ndikuar po ashtu në fuqizimin e ideologjisë së ekstremit të djathtë.

Rënia ekonomike i ka bërë natyrshëm qytetarët evropianë më të prirur ndaj propagandës nacionaliste. Grupet e ekstremit të djathtë kanë përfituar nga kjo situatë duke përdorur narrativa të rreme që fajësojnë fluksin e emigrantëve dhe refugjatëve si arsyeja pse ekonomia është në recesion. Për më tepër, këta aktorë të djathtë përdorin gjuhë ksenofobike që synojnë të bindin qytetarët se ardhja e emigrantëve do të çojë në asimilimin e kulturës së tyre.

Efektet e veprimeve të ekstremistëve të djathtë janë të dukshme dhe prekin rëndë komunitetet. Nëse janë efektive, ato mund të përbëjnë një rrezik serioz për demokracinë dhe vlerat si liria e fjalës dhe toleranca fetare. Lëvizje të tilla janë përshkallëzuar më parë në akte dhune, duke paraqitur një rrezik të madh për sigurinë si për institucionet ashtu edhe për grupet minoritare.

Për të trajtuar këtë çështje, qeveritë Evropiane duhet të përmirësojnë politikën ekonomike zhvillimin, komunikimin efektiv ndërmjet grupeve shoqërore dhe sundimin e ligjit. Në mënyrë që të sigurohet se këto masa janë zbatuar në mënyrë korrekte, koordinimi ndërmjet institucioneve qeveritare, shoqëria civile dhe qytetarët e zakonshëm janë vendimtare.

Viteve të fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të aktivitetit të grupeve të krahut të së djathtës ekstreme në Serbi. Ky hulumtim synon të nxjerr në pah disa nga shkaqet kryesore të kësaj tendence dhe ndikimin e saj në Serbi dhe rajon.

Ultra-nacionalizmi është faktori kryesor kulturor pas rritjes të së djathtës ekstreme në Serbi. Grupet e krahut të së djathtës ekstreme përdorin propagandën me prapavijë historike për të portretizuar historinë e Serbisë si të tillë të një vendi superior në krahasim me të tjerët. Për më tepër, këto grupe paraqesin ngjarje historike të kohëve të fundit, si shkatërrimi i Jugosllavisë, si raste ku Serbia ishte viktimë dhe u trajtua ashpër nga aktorët ndërkombëtarë, duke nxitur ndjenjat e viktimizimit.

Përveç faktorëve kulturorë, ka edhe arsye tjera për ngritjen e së djathtës ekstreme si p.sh. vështirësitë ekonomike. Sipas të dhënave të Macrotrends, 12% e popullsisë serbe jeton me më pak se 5.50 dollarë në ditë, ndërsa 21% e popullsisë është në rrezik të rënies në nivelet e varferisë. Aktorët e të djathtës ekstreme manipulojnë këta individë duke fajësuar vende të huaja, organizata euro-atlantike dhe emigrantët për mungesën e mundësive të punës.

Në përputhje me tendencat globale, radikalizmi në Serbi sot ndodh më shpejt se kurrë më parë përmes platformave të mediave sociale. Përmes mediave sociale, aktorët e së djathtës ekstreme mund të identifikojnë lehtësisht grupet e marginalizuara që nuk janë të kënaqura me pozitën e tyre shoqërore dhe t'i shenjestrojnë ata me propagandë.

Pasojat e rritjes e së djathtës ekstreme janë ndjerë në një numër të grupimeve në vend, duke rezultuar në veprime të dhunshme kundër minoriteteve etnike, fetare dhe seksuale. Duke marrë parasysh kontekstin historik, rritja e akteve në Serbi natyrshëm ka një ndikim në stabilitetin rajonal dhe vë në diskutim edhe mundësinë e konflikteve në Ballkan.

Përfaqësuesit tipik të së djathtës ekstreme serbe janë: Nonça Patrolla, Obraz, Dveri etj.

Ne kemi përzgjedhur katër eksponentë aktivë të së djathtës ekstreme evropiane që nëpërmjet lidhjeve të ngushta me Serbinë ushtrojnë aktivitete të dëmshëm kundrejt interesit shtetëror të Kosovës.

Arnaud Guillon



Arnaud Guillon, një figurë publike me lidhje me autoritetet serbe, ka luajtur një rol të rëndësishëm në destabilizimin e institucioneve demokratike të Kosovës. Si një aktivist i ekstremit të djathtë, Guillon ka propaganduar vazhdimisht ndjenja nacionaliste duke minuar sovranitetin dhe stabilitetin e Kosovës. Duke vepruar përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë mediat dhe platformat sociale, Guillon ka shpërndarë në mënyrë aktive dezinformata që synojnë diskreditimin e aspiratave legjitime të Kosovës.

Për më tepër, Guillon është akuzuar për nxitje të tensioneve përmes veprimeve provokuese dhe retorikës, duke kërkuar të përkeqësojë ndarjet ekzistuese etnike brenda Kosovës. Aleanca e tij e ngushtë me autoritetet serbe i ka dhënë atij burimet dhe mbështetjen e nevojshme për të ushtruar metoda hibride kundër shtetit të ri, duke penguar përparimin e tij drejt stabilitetit dhe unitetit. Përveçse mori pasaportën serbe, Qeveria e Serbisë, me 26 nëntor 2020, e emëroi Arnaud Guillon në krye të një drejtorie të rëndësishme të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Arnaud Guillon, shtetas francez (i lindur në vitin 1985), i natyralizuar si një qytetar serb dhe i konvertuar në ortodoks në Kishën Ortodokse Serbe, në Manastirin e Deçanit, është përfaqësuesi tipik se si një përfaqësues i ekstremit të djathtë evropian, dhe i ndikuar nga Rusia, bëhet faktor proapagande e destabiliteti në Ballkanin Perëndimor. Sot, Drejtor i Drejtorisë për Bashkëpunim me Diasporën dhe Serbët në Regjion në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Serbisë, Arnaud Guillon, karrierën e ka nisur si ksenofob në Francë, në vitin 2003.

Arnaud Guillon u bashkua me “Identitaires” në 2003, pothuajse qysh në shfaqjen e strukturës. Kjo organizatë lindi pas shpërbërjes së grupit nationalist-revolucionar “Unité Radicale”, pasi një nga mbështetësit e tij u përpoq të vriste Presidentin francez Shirak më 14 korrik 2002. Guillon si 18-vjeç, ishte pjesë e brezit të parë të Jeunesses Identitaires, nga të cilat ai shpejt u bë kreu i seksionit të Grenoble. Megjithëse i njohur për për aftësi menaxheriale, Guillon ruajti pamjen naziste dhe shfaqjen e dhunës në aktivitetet e ekstremit të djathtë.

Arnaud Guillon



I pranishëm në festimin e Ditës së Majit 2005 të Identitaires në Nice, ai u përfshi kështu, së bashku me disa të tjerë (vëllai i tij Bertrand si dhe Olivier Roudier, ndër të tjerë) për dhunën raciste të kryer një ditë para festimit në Nicën e vjetër. Ai është themelues i shoqatës “Solidarité Kosova” (2005), rrënjët e së cilës janë ngërthyer thellë në një ideologji politike pan-evropiane nacionaliste të së djathtës ekstreme. Megjithëse, ka shpërndarë ndihma tek enklavat serbe në Kosovë, organizata “Solidarite Kosovo”, i ka shërbyer Guillon-it, më shumë si “Kalë Troje” që të depërtojë në mjediset publike jo vetëm të Francës, por edhe në shtetet të tjera të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2007, zgjidhet udhëheqësia e re e “Identitaires”. Arnaud Guillon, u bë zëdhënës i organizatës. Në vitin 2008, Arnaud Guillon, kishte vizituar Parlamentin Evropian, ku kishte lobuar për interesat serbe karshi Kosovës, në prag të fillimit të misionit të EULEX-it. Në një deklaratë për media, kishte thënë se “ne do t’ua shpjegojmë atyre një këndvështrim tjetër të gjendjes në Kosovës, për dallim prej lobistëve shqiptarë dhe mediave perëndimore”.

Në vitin 2009, në Beograd, në një miting përkujtues kundër bombardimit që i bëri NATO Serbisë, Guillon pati deklaruar se “ekstremistë janë ata serbë që po duan ta shesin Kosovën dhe Metohinë për 3 para; ekstremistë janë ata që e kanë bombarduar Serbinë”. Ai më tej kishte thënë, me gjuhën e opozitarit francez, se “politikanët francezë nuk na kanë pyetur neve kur e pranuan Kosovën si shtet e as kur e bombarduan Serbinë”. Ka organizuar mitingje propagandistike kundrejt “terroristëve shqiptarë”. Ai ka marrë pjesë edhe në demonstrata në disa qytete evropiane, kundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Mediet franceze, kanë pasqyruar aktivitetin e dhunshëm të “Identitaires” dhe Guillon-it gjatë gjithë kohës. Shpeshherë, autoritetet vendore franceze, i kishin ndaluar tubimet e kësaj “lëvizje identiteti”, në emër të ruajtjes së rendit. Lëvizja e Guillon-it shpeshherë ka bashkëpunuar me grupet no-naziste në Francë kundër “amerikanizimit” dhe “islamizimit” të Francës.

Arnaud Guillon

Në vitin 2010, Arnaud Guillon nominohet nga “Identitaires” në garën për zgjedhjet presidenciale në Francë të vitit 2012. Me këtë rast hoqi dorë nga udhëheqja e organizatës “Solidarite Kosovo”. Në vitin 2009, Arnaud Guillon, në cilësinë e pjesëtarëtit të identitarëve francezë, merr pjesë në organizimin nacionalist serb, të ashtuquajturin “Marshin e Vidovdanit”, i cili u organizua nga ekstremistët e djathtë “Narodni Pokret 1389”. Në këtë aktivitet, morën pjesë edhe organizata të tjera ortodokse e naziste, ndër të cilët edhe organizata e shpallur terroriste nga SHBA, Lëvizja Imperialiste Ruse edhe, e cila më vonë u shpall terroriste nga SHBA.

Në disa tubime elektorale ishin edhe të dhunshme, të njohura si “marshi i derrave”, të cilat ishin drejtuar kundër dyqaneve ushqimore, të cilat edhe u plaçkitën. Në mungesë të përkrahjes, më 11.9.2011, Guillon, tërhiqet nga gara për president të Francës. Mirëpo, një marrëveshje në mes të “Bloc Identitaire” dhe Marine Le Pen-it (National Front) krijuar për bashkëpunim.

Në fillim të aktivitetit publik me “Bloc Identitaire”, Arnaud Guillon u paraqit me mbiemrin Borella. Më vonë, në vitin 2017, në një televizion serb, kur u pyet për aktivitetin e tij në “Bloc Identitaire”, Guillon, duke tentuar që ta fshehë të kaluarën e tij, tha se “në këtë lëvizje kam qenë vetëm gjashtë muaj gjatë viteve 2010 dhe 2011”. Ndërsa, siç shihet në ueb-in kronologjik të identitarëve francezë, Guillon, zyrtarisht kishte filluar veprimtarinë në vitin 2007. Pas tërheqjes nga gara për zgjedhjet presidenciale në Francë, Guillon, e vazhdon aktivitetin e tij më organizatën “Solidarite Kosovo”. Mirëpo, bashkëpunimin me përfaqësues të së djathtës evropiane i vazhdoi.

Në vitin 2012, në Vjenë u takua dhe mbajti një konferencë të përbashkët me Heinz Christian Strache (përfaqësues i ekstremit të djathtë austriak, i përfshirë në një skandal korrupsioni së bashku me një oligark rus). Në vitin 2016, Strache kishte nënshkruar një “pakt bashkëpunimi” me partinë e Putinit “Rusia e Bashkuar”, gjë që ishte e paprecent për një parti politike në Evropën Perëndimore. Narracioni i ekstremit të djathtë i Arnaud Guillon-it vazhdoi edhe me “Solidarite Kosovo”. Në aktivitetet që i kanë bërë në Evropën Perëndimore, moto e veprimtarisë së tij ishte mbrojtja e “serbëve të krishterë” nga “Shqiptarët terroristë islamikë”.

Arnaud Guillon

Sipas raportit financiar të organizatës “Solidarite Kosovo”, vetëm në vitin 2017, të hyrat e përgjithshme kanë qenë mbi 1 milion euro. Ndërsa, shuma që kanë përfituar serbët nga ajo ka qenë shumë modeste. Rrjedhimisht, “Solidarite Kosovo” e Arnaud Guillon ka në dispozicion shumë të mëdha financiare, të cilat i përdor jo vetëm për ndihmë ndaj serbëve, por edhe për sulmin propagandistik ndaj “terroristëve shqiptarë”.

Kjo organizatë, në dy nga burimet e saj informuese, dallon në veprimtari. Gjersa, në faqen e facebook-ut, thotë se “serbëve të Kosovës iu ofron ndihma materiale dhe morale”, në raportin financiar, thuhet se “ka për qëllim ofrimin e ndihmës urgjente për serbët e Kosovës dhe Metohisë, si dhe për informimin dhe ngritjen e vetëdijes publike për situatën e tyre”. Së këndejmi, shihet se “Solidarity Kosovo”, më shumë merret me propagandën sesa me ndihmat humanitare.

Arnaud Guillon (i lindur 1985 në Jarrie të Francës) është i martuar me serben Ivana Gajiç. Që nga viti 2012 jeton në Serbi. Në vitin 2015, ka marrë pasaportën serbe, ndërsa Kisha Ortodokse e Serbisë e ka dekoruar me medaljen më të lartë të saj. Përveç frëngjishtes, flet anglisht, serbisht dhe rusisht. Marrë parasysh promovimin e ideve të ekstremit të djathtë në Serbi, të ngjashme me idetë ruse, Arnaud Guillon u emërua si Drejtor i Zyrës për Bashkëpunim dhe Diasporë të serbëve në rajon në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Serbisë, madje ai është shpërblyer me dekoratat më të larta shtetërore dhe kishtarë të Serbisë, për kinse angazhimin e tij humanitar.

Kristian Kahrs



Kristian Kahrs, një tjetër aktivist i ekstremit të djathtë me lidhje të forta me autoritetet serbe, ka qenë një forcë shtytëse pas përpjekjeve për të sfiduar funksionalitetin shtetëror të Kosovës. Kahrs ka përdorur platforma online dhe media alternative për të përhapur dezinformata rreth Kosovës, duke vënë në pikëpyetje legjitimitetin e saj si shtet i pavarur. Përmes një rrjeti individësh me të njëjtin mendim, Kahrs ka kërkuar në mënyrë aktive të ndryshojë narrativën ndërkombëtare që rrethon Kosovën, duke mashtruar audiencën globale rreth realiteteve të saj politike, sociale dhe ekonomike.

Për më tepër, lidhjet e Kahrs me autoritetet serbe i kanë mundësuar atij qasje në informacione të ndjeshme, të cilat ai i ka përdorur për të nxitur komplete dhe narrativa të rreme rreth udhëheqjes së Kosovës dhe institucioneve demokratike. Kjo fushatë dezinformuese ka kontribuar në një klimë mosbesimi dhe destabiliteti, duke penguar përparimin e Kosovës si një shtet sovran.

Kristian Kahrs është gazetar dhe ish-ushtarak i Ushtrisë së Norvegjisë, i cili shërbeu si oficer për komunikim me media në KFOR - Kosovë. Ai filloi të fitojë famë të madhe në Serbi, pasi promovonte publikisht pikëpamjet e tij radikale antisemetike, homofobike dhe raciste, si pjesë e organizatës së ekstremit të së djathtës serbe (neo-naziste), Obraz. Karrierën e tij publike e nisi si gazetar në vitin 1993. Në vitin 1994, shkoi për herë të parë në Serbi dhe në Maqedoni. Një vit më vonë, në verën e vitit 1995, shkoi në Krime të Ukrainës për ta përcjellë (si gazetar) konfliktin në mes të Ukrainës dhe Rusisë.

Punën e gazetarit e vazhdoi edhe në disa revista lokale norvegjeze, në mesin e të cilave edhe si redaktor i “Storsalen Online”, organ i kishës në Oslo. Pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, në vitin 2000, Kahrs punoi si redaktor në “KFOR Online”.

Kristian Kahrs

Kristian Kahrs punoi si gazetar i “Christianity Today”, duke raportuar nga Afganistani dhe Pakistani (2001 – 2002). Pas 4 vitesh, në vitin 2004 i kthehet rajonit Ballkanik, duke provuar që përmes një agjencie shtetërore norvegjeze, të krijojë kanale të reja komunikimi në mes të shqiptarëve dhe serbëve. Gjatë periudhës 2015 – 2017, zyrtarisht u angazhua në politikë në Norvegji, në partinë e së djathtës ekstreme, “Demokratene”. Që nga viti 2005, kjo parti asnjehere nuk kishte arritur që të fitonte asnjë mandat deputeti në Parlamentin Norvegjez. Partia “Demokratene”, sipas programin politik, angazhohet për marrëdhënie të mira me Rusinë, por gjithashtu edhe me NATO-n.

Megjithatë, Kristian Kahrs, nuk ia doli që të mbetet aktiv gjatë në parti. Ai u përfshi në disa konflikte brenda partisë, ku fshehtas kishte incizuar disa audio brenda partisë, të cilat ia dërgoi për publikim një gazetari kontravers norvegjez. Gjithnjë sipas burimeve brenda partisë, Kristian Kahrs përpiquej që t’i prishte marrëdhëniet e Norvegjisë me SHBA, kurse kishte lobuar për marrëdhënie të mira me Serbinë dhe Rusinë. Gjatë, përpjekjeve për t’u rreshtuar sa më mirë në krye të partisë, Kristian Kahrs, kishte komunikuar me Sekretarin e Dytë në Ambasadën e Rusisë në Norvegji, Andrey Kulikov.

Angazhimet propagandistike e politike të Kristian Kahrs-it, janë të së njëjtës ideologji me ekstremin e djathtë francez, atë gjerman dhe serb. Në mediet serbe, ai angazhohet që ta komprometojë qëllimin e bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë, e cila ishte bërë për ndalimin e përpjekjes për gjenocid ndaj shqiptarëve të Kosovës. Kristian Kahrs, gjithashtu është angazhuar me pjesëmarrje fizike edhe në protestat e së djathtës ekstreme serbe kundër pushtetit malazez.

Kristian Kahrs

Përfshirja e Kahrs-it në aktivitetet e së djathtës ekstreme në Serbi ishte edhe kundër vet pushtetit në Beograd. Ai ka marrë pjesë në shumë të tilla, duke u nisur nga kërkesat e veteranëve serbë të luftës. Pothuajse në çdo organizim publik të të gjitha organizatava nacionaliste serbe. E përbashkëta e tyre është se, të gjitha aktivitetet kanë pasur target final, sulmin ndaj NATO-s dhe shoqërive liberale perëndimore. Në vitet e fundit, pothuajse nuk ka ngjarje që organizohet kundër NATO-s, që Kahrs nuk merr pjesë, e mundësisht edhe të jetë njëri ndër spikerët kryesorë. Duke qenë me përvojë të gjatë si influencues, Kahrs, nxit masat e pjesëmarrësve nëpër mitingje në Serbi që të elektrizohen, duke i thirrur ata në nacionalizëm, urrejtje ndaj “atyre që e dëmtuan Serbinë dhe poipullin serb”.

Në janar të vitit 2019, kur Beogradin e vizitoi presidenti rus Vladimir Putin, Kahrs, përmes kanalit të tij në Youtube, i bëri thirrje atij në gjuhën angleze dhe atë serbe që “t’ia dhuronte sistemin raketor rus S-400 Serbisë që të mbrohet nga agresioni shqiptar, që të mbrohet nga agresioni i NATO-s, që të mbrohet nga agresioni Norvegjisë si anëtar i NATO-s”. Në përpjekje e sipër për ta diskredituar çdo vend të NATO-s dhe BE-së, Kahrs, me prezencë fizike, nga Zagrebi, në vitin 2019, kur iu kishte ndaluar hyrja në stadium, transmetoi një video, ku e quante Kroacinë si “vend të ustashëve”. Për ta rritur më shumë autoritetin e tij tek ekstremistët e djathtë dhe mediat në Serbi, Kahrs, zakonisht mban të veshura fanella me parolla nacionaliste serbe. Shpesh, ato përmbajnë edhe portretin e Putinit ose mbishkrim “Rusia”.

Si influencues, Kahrs nuk zgjedh metoda të ndikimit në dëm të NATO-s dhe personaliteteve, siç i quajnë ata “NATO-globalistëve”, shprehje kjo e mbjellë nga Kremli. Kristian Kahrs ka raporte të afërta edhe me bashkëpunëtoren e shërbimeve të inteligjencës ruse, Dragana Trifkoviçin. Gjithashtu, ai shoqërohet edhe me luftëtarë serbë, të cilët kanë marrë pjesë në krah të forcave paramilitare ruse në Krime të Ukrainës, siç është rasti me çetnikun Bratisllav Zhivkoviç. Në tubimet e përvjetshme në Gazimestan, afër Prishtinës, ku zakonisht mblidhet ultranacionalistët serbë proruse, edhe Kristian Kahrs ka qenë prezent. Në vitin 2012, ai, duke u thirrur se është gazetar, përpiquej që ta pengonte punën e Policisë së Kosovës, e cila po ndalonte simbolet nacionaliste serbe e ruse. Kristian Kahrs shkruan edhe për “The Duran”, kompani mediale e regjistruar në Qipro, e cila është e njohur me përmbajtjen proruse.

Maik Müller



Maik Müller, një lojtar kyç në rrjetin e aktivistëve të ekstremit të djathtë, ka luajtur një rol të dëmshëm në minimin e demokracisë dhe funksionalitetit shtetëror në Kosovë. Duke përdorur lidhjet e tij me autoritetet serbe, Müller ka qenë instrumental në koordinimin e fushatave dezinformuese që synojnë ta portretizojnë Kosovën si një shtet të paqëndrueshëm dhe të paaftë. Përpjekjet propagandistike të Müller-it kanë synuar audiencën ndërkombëtare, duke kërkuar të ndikojë opinionin publik dhe politikëbërësit kundër mbështetjes së shtetësisë së Kosovës. Duke shtrembëruar faktet dhe duke përforcuar incidente të izoluar, Müller është përpjekur të krijojë një imazh të rremë të Kosovës si një shtet i dështuar, duke minuar kështu legjitimitetin e saj në skenën globale.

Maik Muller është përfaqësues i partisë së ekstremit të djathtë gjerman NPD (Nationaldemokratische Partei Deutschlands), përkatësisht i organizatës së saj rinore Junge Nationalisten. Ai ka lindur dhe jeton në Dresden të Gjermanisë, qytet i njohur për influencën ruse. Është udhëheqës i organizatës “Fronti i Solidaritetit Evropian me Kosovën” (Europäische Solidaritätsfront für Kosovo), formalisht e njohur për aktivitet humanitar, por e cila në Gjermani dhe vendet gjermanofolëse merret me ndikim politik, kundër demokracisë liberale perëndimore dhe NATO-s dhe SHBA-së. Muller është konvertuar në Kishën Ortodokse Serbe në vitin 2016.

Maik Muller i prin aleancës neo-naziste “Dresden Gedenken”, e cila, sipas medieve perëndimore, falsifikon historinë duke organizuar demonstrata për përvjetorët e bombardimit të Dresdenit në shkurt të vitit 1945. Viteve të fundit, demonstratave të këtij përvjetori iu bashkohen edhe ekstremistë të tjerë të krahut të djathtë të shteteve të tjera, si nga Franca, Italia, Greqia, Republika Çeke, Suedia, Rusia dhe Serbia.

Maik Müller

Maik Muller, personi i paraqitur para organeve të rendit në Gjermani, është organizatori i këtyre demonstratave. Devijimi i të dhënave historike që paraqiten në këto demonstrata, dëshiron që ta relativizojë holokaustin – katastrofën njerëzore që i ka bërë Gjermania e Hitlerit ndaj hebrenjve. Fjalimet e Muller-it, si udhëheqës, fryjnë numrin e viktimave të Dresdenit nga bombardimet që i kishte bërë Anglia dhe SHBA nga 25,000 në 200,000. Njësoj si me narracionin për “viktimizimin e Dresdenit”, Muller vepron edhe për bombardimet e NATO-s ndaj Serbisë në vitin 1999, duke e quajtur agresion dhe duke e “viktimizuar Serbinë”.

Maik Muller si përfaqësues i neo-nazistëve në Dresden të Gjermanisë, propagandën dhe devijimet historike i bazon në narracionin rus, dhe kryesisht ia dedikon audiencës së ekstremist të djathtë dhe instituteve proruse. Një të tillë, e mbajti në shtatorin e vitit 2020, në Vjenë të Austrisë në Institutin “Sovorov”, udhëheqësit e të cilit janë dekoruar nga presidenti i Federatës Ruse Vladimir Putin.

Sipas raportit të botuar, Maik Muller, në Kongresin e Tretë Evropian të “Nacionalistëve të Rinj”, i cili u mbajt në Riesa, në veri-perëndim të Dresdenit, më 11 dhe 12 maj të vitit 2018, u konstatua se partia e tij angazhohet për “Daljen (e Gjermanisë) nga NATO-ja dhe marrëdhëniet e mira me Rusinë”. Në këtë Kongres, morën pjesë edhe përfaqësues nga Lëvizja Imperialiste Ruse, e cila u shpall organizatë terroriste nga SHBA.

Maik Müller

Maik Muller ka vizituar vende të Ballkanit perëndimor disa herë. Veçmas, ai është koncentruar në Kosovë, ku përmes organizatës së tij të ashtuquajtur humanitare “Fronti i Solidaritetit Evropian me Kosovën”, krijon lidhje me përfaqësues të dë djathtës ekstreme serbe. Nga bashkëpunëtorët e tij që mund të dëshmojnë në mesin e komunitetit serb në Kosovë është Zvonko Mihajlovic, zyrtar i lartë i Partisë Radikale Serbe të Vojslav Sesel-it.

Bashkëpartiakë të Maik Mullerit kanë marrë pjesë në trajnime ushtarake në kampet ruse në St. Petersburg të Rusisë. Pjesë e trajnimit ishte edhe përdorimi i armëve dhe eksplozivëve, si dhe trajnimi për luftime të afërta. Aktiviteti më i shtuar në rrjete sociale i Maik Mullerit është ai që ka të bëjë me propagandën anti-NATO dhe proserbe. Ai shfrytëzon profilin në facebook me emrin “Maximilian Broën”. Është përfshirë edhe në përkrahje të kërkesave të Kishës Ortodokse Serbe në Malin e Zi, përkatësisht provimit të tyre. Për t’ia rritur popullaritetin më shumë dhe, rrjedhmisht për të pasur fuqi më të madhe influencuese, mediat shtetërore ruse, veçmas RT i ka transmetuar në vazhdimësi demonstratat se së djathtës gjermane, të cilave u ka prirë Maik Muller.

Yves Bataille



Yves Bataille, i njohur për pikëpamjet e tij ekstremiste dhe lidhjet me autoritetet serbe, ka qenë një lojtar kyç në përpjekjet e përbashkëta për të manipuluar narrativën e Kosovës. Nëpërmjet mediave sociale dhe platformave online, Bataille ka propaganduar përmbajtje përçarëse, duke rrënjësuar më tej tensionet ekzistuese etnike dhe duke kontribuar në një atmosferë armiqësie brenda Kosovës. Në bashkëpunim me aktivistët e tjerë, Bataille është angazhuar në një përpjekje të koordinuar për të minuar funksionalitetin shtetëror të Kosovës, duke e portretizuar shtetin si të paaftë për të qeverisur veten. Veprimet dhe retorika e tij kanë synuar gjithashtu aleatët ndërkombëtarë të Kosovës, duke u përpjekur të largojnë mbështetjen e tyre. Francezi Yves Bataille është përfaqësuesi i së djathtës evropiane proruse, i cili në rajonin e Ballkanit Perëndimor ka ardhur ndër të parët. I lindur në Algjeri (1949), Yves Bataille ka ndjekur oborret e grupeve ekstra-parlamentare të së djathtës ekstreme franceze për 50 vjet.

Prorus dhe një antiamerikan i ashpër, ai është një nga figurat e fundit historike të lëvizjes nacionaliste-revolucionare NR. Me kalimin e kohës ai është bërë një referencë në ekstremin e djathtë dhe në qarqet NR për të gjitha pyetjet që lidhen me Rusinë dhe Evropën Lindore. Yves Bataille u përjashtua nga lëvizja neonaziste “Rendi i Ri” në shtator të vitit 1971, nga pozita e kryterarit të seksionit të Nantes. Bataille shkroi në disa revista politike të organizatave të djathta, kurse më 1975 u bë kryeredaktor i “Cahiers du CDPU”.

Në Nëntor 1987 Yves Bataille mori pjesë në Paris në takimet e organizuara nga Partia Komuniste Nacionaliste (PCN) për të nisur një strukturë të re në shkallë evropiane. Projekti dështoi. Në Paris u njoh dhe më pas u martua me psikologjen, shkrimtaren dhe ultranaconalisten serbe dr. Mila Aleckovic. Në vitin 1991 filloi njohjen me serbët në Francë dhe interesimin për konfliktin në Jugosllavi. Ndërsa, në vitin 1992, themeloi Asociacionin Serbo-Francez, kryetar i së cilës u bë. Në 1993 Yves Bataille u transferua në Serbi. Gjatë luftërave në ish-Jugosllavi, ai mbajti anën e serbëve.

Yves Bataille

Në korrik 1995, Yves Bataille u takua me udhëheqësin politik të serbëve në Bosnjë Radovan Karadjic-in, në Pale, nga i cili pranoi edhe medale. Gjatë takimit, Karadjic mori një faks nga Kombet e Bashkuara, në të cilin tregoi se Kombet e Bashkuara ishin të kënaqur me evakuimin e civilëve nga Srebrenica. Bataille e publikoi këtë faks në një artikull në gazetën javore "National HEBDO" në fund të korrikut dhe fillimit të gushtit 1995. Yves Bataille ka ndërmjetësuar vizitën e kryetarit të Frontit Nacional të Francës dhe anëtarit të Parlamentit Evropian, Jean Marine Le Pen, që ta vizitojë Beogradin në janar të vitit 1997. Qëllimi i vizitës ishte bashkëpunimi me Partinë Radikale Serbe të Vojsilav Sesel-it.

Në vitin 2003, si drejtor i "La Lettre Géopolitique", Yves Bataille mori pjesë në "Universitetin e 4-të Veror për Lëvizjet E Gjelbërta Pacifiste dhe Alternative", në Paris. Aty u gjendën Partia Komuniste e Belgjikës, lëvizjet libiane pranë Gadafit dhe aktivistët radikalë mjedisorë. Bataille u përfshi në temën "modus operandi e SHBA-së në luftën Jugosllave" si dhe në tryezën e rrumbullakët "Vendi i Irakut në projektet imperialiste të SHBA".

Azerbajxhan, ku kishte interesa ruse, Yves Bataille kishte marrë pjesë si një "vëzhgues" ndërkombëtar. Megjithatë, edhe pse ai ishte së bashku me bashkëshorten e tij, Mila Aleckovic, ishte shpallur persona "non grata" nga shteti azerbajxhanas. Në qershor të vitit 2013, Yves Bataille ishte pjesë, si dëshmitar i mbrojtjes së Radovan Karaxhiqit, në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës. Yves Bataille është përfshirë shpeshherë edhe në Kosovë. Ai ka qenë pjesëmarrës aktiv i debateve për Kosovën, duke i kritikuar të gjitha qeveritë në Serbië se "e kanë shitur/po e shesin Kosovën". Me Kosovën është marrë edhe para vitit '90-ta, kur e kundërshtonte "një republikë islamike në Jugosllavi". Bataille, duke qenë i afërt me strukturat e radikalëve serbë, e më vonë edhe të të djathtëve ekstremë në Serbi, ka përfaqësuar dogmat e tyre në raport me Kosovën dhe vendet e tjera ku jetojnë serbët jashtë Serbisë.

Yves Bataille

Në Beograd, Bataille thërriste serbët edhe për protesta kundër Francës. Në profilin e tij në rrjete sociale, kishte shkruar: “Të mblidhemi nesër përpara Ambasadës Franceze në Beograd (rr. Gračanicka, 18) në orën 12:00. Lëvizja e madhe botërore kundër Vdekjes. Kurse, për jetë dhe familje protesta fillon më 26 maj, në qendër të Parisit, ku pritet të marrin pjesë 2 milionë njerëz. Populli i okupar francez, është ngritur në këmbë kundër shthurjes së familjes, kundër olikarkisë së Brukselit, hajdutërisë dhe NATO-s, me parullën ‘Nuk kemi qenë dhe asnjëherë nuk do të jemi koloni amerikane!’ Evropianët e vërtetë u ngritën. Policia po ushtron dhunë në ta dhe po i burgos. Përfaqësuesi rus ka arritur në Paris që ta japë përkrahjen në emër të popullit rus. Kryengitjen nga Serbia e udhëheq DVERI.... Serbia – Franca – Rusia”.

Në vitin 2013, kur me njëjërën nga marrëveshjet në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë, që vdenosur që edhe serbët e komunave veriore të marrin pjesë në zgjedhjet e Republikës së Kosovës, Yves Bataille, së bashku me struktura të së djathtës ekstreme, mori pjesë edhe fizikisht në demonstratat që ftonin për bojkotimin e zgjedhjeve. Në njëjërën nga to, më 21.10.2013, në Mitrovicën Veriore, përveç se ftoi në bojkot të zgjedhjeve, ai tha se “demonstrata e sotme është qëndrim kundrejt tradhtarëve (serbë), rezistencë kundër disave në shtetin e Serbisë, të cilët bashkëpunojnë me amerikanët dhe perëndimin. Ata janë ‘të paguar’, hajdutë dhe mashtrues. Sot, është koha për rezistencë popullore. Kurse, nesër, së bashku me Rusinë dhe Serbinë, dhe së bashku me disa francezë, do të nisemi për çlirimin e Kosovës”. Në marshin protestues, i cili përmbante simbole nacionale serbe e ruse, Yves Bataille ishte në krye të marshit, së bashku me liderët radikalë serbë, ku të gjithë së bashku mbanin transparentin “Kosova është Serbi”.

Yves Bataille

Në vitin 2016, së bashku me filozofin ultranacionalist rus Alexandr Dugin, Yves Bataille mori pjesë në thirrjen për formimin e një Kominterni të ri anti-imperialist. Që nga ajo kohë e më tej, Yves Bataille ka raporte shumë të mira me Dugin-in. Madje, Dugin, jo si zakonisht, ka marrë pjesë edhe në një emision në një tv minor në Serbi, të cilin e udhiqte bashkëshortja e Bataille, Mila Aleckovic.

Në vitin 2016, së bashku me filozofin ultranacionalist rus Alexandr Dugin, Yves Bataille mori pjesë në thirrjen për formimin e një Kominterni të ri anti-imperialist. Që nga ajo kohë e më tej, Yves Bataille ka raporte shumë të mira me Dugin-in. Madje, Dugin, jo si zakonisht, ka marrë pjesë edhe në një emision në një tv minor në Serbi, të cilin e udhiqte bashkëshortja e Bataille, Mila Aleckovic.

Bataille, duke përfaqësuar konkretisht interesat gjeopolitike ruse, ka marrë pjesë në çdo demonstratë kundër pushtetit në Serbi. Madje, në korrik të vitit 2019, ai ka qenë i përfshirë në një përleshje fizike, ku ishte lënduar. Për demonstratat e kësaj kohe, vet pushteti në Serbi, kishte deklaruar se janë të përfshirë agjentura të huaja.



Përfundimi

Veprimtaria e eksponentëve të së djathtës ekstreme evropiane që veprojnë në bashkëpunim të ngushtë me Serbinë shpesh herë maskohet nën petkun e aktivistëve të shoqatave humanitare, dhe këto fakte duhet të ekzaminohen me kujdes. Shumë nga këta eksponentë themelojnë edhe shoqata të tjera, si fasilitimi i komunikimit ndëretknik apo veprimtari të ngjashme. Në fakt kjo është vetëm mbulesë e aktiviteteve të tyre të vërteta, që është propaganda dhe lufta hibride. Maskimi u mundëson këtyre eksponentëve të punojnë larg syrit të medieeve dhe u jep liri të konsiderueshme veprimi. Profili i ulët publik që disa nga eksponentët e së djathtës ekstreme zakonisht mbajnë jo domosdoshmërisht është edhe indikacion i rrezikut të ulët. Ata mund të jenë po aq të dëmshëm për interesin nacional të Kosovës edhe kur mund të jenë jo shumë të njohur për publikun.

Për të zvogëluar këto rreziqe, shtetet e Ballkanit perëndimor duhet të përforcojnë insitucionet demokratike, sundimin e ligjit dhe pavarësinë e mediave. Për më tepër duhet të promovohet kredibiliteti i mediave dhe të rriten përpjekjet edukative në menyrë që brezat e rinj të zhvillojnë aftësi më të thella të mendimit kritik dhe të jenë të aftë të mendojnë në mënyrë të pavarur, pavarësisht nga narrativat e rreme që mund t'u drejtohen. Bashkëpunimi me partnerët rajonalë dhe partnerët nderkombetarë si Bashkimi Europian është çelësi kryesor, duke marrë parasysh përvojën dhe burimet që kanë në trajtimin e çështjeve të tilla.

Rekomandimet



Stabilitet Politik dhe
Qeverisje më të fortë

- Mbështetje për udhëheqësit politikë të "luftojnë" kundër ekstremizmit të djathtë dhe të promovojnë politika të përfshirëse për të mbrojtur qytetarët e tyre.
- Përmirësim i institucioneve demokratike dhe strukturës së qeverisjes përmes ligjit dhe masave për të parandaluar ambientin e politikave të ekstremizmit të djathtë.

Adresim i Faktorëve
Soci-ekonomik

- Investime dhe mundësi për arsimim, punësim dhe trajnim për të përmirësuar kushtet jetësore dhe mundësitë ekonomike.

Rekomandimet



Luftimi i Radikalizmit
në Internet

- Ndërtimi i kapaciteteve me kompanitë teknologjike për të hequr përmbajtje ekstremiste nga platformat e mediave sociale.

Forcimi i
Bashkëpunimit Policor
dhe Inteligjencës

- Promovimi dhe inkurajimi për ndarjen e informacionit dhe shkëmbimin e inteligjencës midis vendeve të Ballkanit dhe Evropës për të ndjekur dhe parandaluar rrjetet ekstremiste të djathta.

References

- SolidariteKosovo. "Arnaud Guillon Parle Des Donateurs Français de Solidarité Kosovo Dans La Presse Serbe." Solidarité Kosovo, January 3, 2022. Accessed 21.07.2023. <https://www.solidarite-kosovo.org/arnaud-guillon-parle-des-donateurs-francais-de-solidarite-kosovo-dans-la-presse-serbe/>.
- Kristian Kahrs,. Kristian Kahrs, March 4, 2022. Accessed 20.07.2023. Accessed 20.07.2023. <https://kristiankahrs.com/>.
- Mönch, Tim, Simone Rafael, and Moritz Aschemeyer. "Neonaziaufmarsch in Dresden: Gegenprotest Verkürzt Naziroute." Belltower.News, February 28, 2020. Accessed 22.07.2023. <https://www.belltower.news/neonaziaufmarsch-in-dresden-gegenprotest-verkuerzt-naziroute-95935/>.
- Karcic, Hikmet. "French Historian and Genocide Denier Yves Bataille, Who Was Karadzic's Defense Witness, and the Link between Jean-Marie Le Pen and Vojislav Seselj. /4 Pic.Twitter.Com/AF89kgQvLm." Twitter, December 3, 2019. Accessed 22.07.2023. https://twitter.com/hikmet_karcic/status/1201970225350090753.
- Redaktion, Endstation Rechts. "Neonazis Ziehen „trauernd" Durch Magdeburg." Endstation Rechts. Accessed 20.07. 2023. <https://www.endstation-rechts.de/news/neonazis-ziehen-trauernd-durch-magdeburg>.
- Die Heimat. "Heimat: Meine Heimat." Die Heimat, July 25, 2023. <https://die-heimat.de/>.
- Verfassungsschutz. "Nationaldemokratische Partei Deutschlands (NPD)." Nationaldemokratische Partei Deutschlands (NPD) - Verfassungsschutz BW. Accessed 20.07.2023. https://www.verfassungsschutz-bw.de/_Lde/Startseite/Arbeitsfelder/Nationaldemokratische+Partei+Deutschlands+ NPD_.
- Ispanovic, Igor. "French Connection: 'humanitarian' Far-Right Claims Kosovo as Cautionary Tale." Balkan Insight, February 16, 2022. Accessed 20.07.2023. <https://balkaninsight.com/2022/02/16/french-connection-humanitarian-far-right-claims-kosovo-as-cautionary-tale/>.
- Davydov, Peter. "Arnaud Guillon, Enfant Terrible of a Forgetful Europe. Peter Davydov." OrthoChristian.Com, December 9, 2020. Accessed 20.07.2023. <https://orthochristian.com/133847.html>.
- BREIZH. "Solidarité Kosovo. Arnaud Guillon, Décoré de La plus Haute Distinction Diplomatique Serbe." BREIZH, June 3, 2018. Accessed 20.07.2023. <https://www.breizh-info.com/2018/06/03/96925/solidarite-kosovo-arnaud-guillon-decore-de-la-plus-haute-distinction-diplomatique-serbe/>.
- Rankovic, Dragica. "Gujon: Scandalous! Twitter Suspended My Account with 34,000 Followers." Telegraf.rs, August 19, 2022. Accessed 18.07.2023. <https://www.telegraf.rs/english/3543272-gujon-scandalous-twitter-suspended-my-account-with-34000-followers>.
- Bouclay, Pierre-Alexandre. "L'incroyable Histoire d'un Humanitaire Français Devenu Ministre En Serbie." Valeurs actuelles, November 27, 2020. Accessed 20.07.2023. <https://www.valeursactuelles.com/clubvaleurs/monde/lincroyable-histoire-dun-humanitaire-francais-devenu-ministre-en-serbie>.
- Latsa, Alexandre. Dissonance, November 4, 2008. Accessed 22.07.2023. <https://alexandre.latsa.ru/2008/11/entretien-avec-yves-bataille/>.
- Macrotrends. Serbia poverty rate 2012-2023, MacroTrends. Accessed 20.07.2023. <https://www.macrotrends.net/countries/SRB/serbia/poverty-rate>.

